



Nr. Ref. BD-225/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me 28 prill 2025 dhe asaj me 16 maj 2025 nëpërmjet këtij vendimi aprovohet si procesverbale të mbledhjeve të Bordit të cekura më lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi procesverbalet e mbledhjeve paraprake të mbajtura me 28 prill 2025 dhe asaj me 16 maj 2025 Dokumenti aprovohet në pajtim me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenin 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2025.


Menfor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/2

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 maj 2025, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet plotësim dhe ndryshimi i Rregullores për Procedurat e Prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore, respektivisht aprovohet Rregullorja nr.04/2025 për Procedurat e Prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për amadamentimin e aktit nënligjor të cekura në paragrafin I të këtij vendimi.

Ky vendim është aprovuar duke pas parasysh faktin se gjatë diskutimeve të mëparshme të Bordit është diskutuar për faktin se ndryshimet e rregullores duhet të përqendrohen te qëllimi i këtyre ndryshimeve është që procedurat të jenë më të qarta, më pak kufizuese, si dhe të mundësojnë një mbikëqyrje më të fuqishme nga ana e AKP-së, me fokus në rritjen e transparencës dhe efektivitetit të monitorimit, duke marrë parasysh se bëhet fjalë për përdorim të fondeve publike. Si rezultat, me datë 8 maj 2025, Drejtori Ekzekutiv ka nxjerrë vendimin nr. DE 959/2025, me të cilin është themeluar Komisioni për plotësim dhe ndryshim të Rregullores mbi Procedurat e Prokurimit për përdorim nga NSH-të.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-225/3

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e parashtrueses së kërkesës e përfaqësuar sipas autorizimit nga , ku bartës i të drejtës banesore: me numër KB-1780/23 (3596) përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 21.05.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH PIK "Kosova Export" Prishtinë (PRN008).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 21.05.2025 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e parashtrueses së kërkesës: e përfaqësuar sipas autorizimit nga ku bartës i të drejtës banesore: për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH PIK "Kosova Export" Prishtinë (PRN008).

Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/4

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banësive mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës , i autorizuar nga ku bartës i së drejtës banesore është (tani i ndjerë) me numër KB-1781/23 (3596) e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 21.05.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga OBPB_(OOUR) Prerada ITRO "Model Gjakovë" (PEJ150).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banësive të datës 21.05.2025 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës , i autorizuar nga ku bartës i së drejtës banesore është (tani i ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga OBPB_(OOUR) Prerada ITRO "Model Gjakovë" (PEJ150). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banësive për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banësive") lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se dokumentacioni i prezantuar nga pala është i pamjaftueshëm për aprovim të kërkesës. Përkatësisht i gjithë dokumentacioni mbështetës i dorëzuar nga pala është kopje dhe i njëjti për të qenë valid për Komisionin duhet të jetë i noterizuar. Gjithashtu mungojnë edhe aktvdekja për , autorizimi për përfaqësim nga trashëgimtarët si dhe faturat komunale për banesën objekt shqyrtimi, përkundër kërkesës së Komisionit për kompletim të dokumentacionit. Andaj, Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/5

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banësive mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Agjencia shpallet jo kompetente për kërkesën me numër KB-42/2011 e parashtruar nga (në emër të 15 punëtorëve të kësaj NSh-je), përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës, si në vijim:

... e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 21.05.2025 për pronën e NSh "Sek Kos" (PRN050).

- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banësive të datës 21.05.2025 me anë të cilit Agjencia shpallet jo kompetente sa i përket kërkesës së palës (në emër të 15 punëtorëve të kësaj NSh-je, të cekur në dispozitiv të këtij vendimi) për blerjen e asetit nga NSh "Sek Kos" (PRN050).


Komisioni për shitjen e banësive në pronësi shoqërore ka shqyrtuar kërkesën e cila përmban 15 kërkesa kreditore për NSh "Sek Kos" Prishtinë (PRN050) në likuidim. Pas shqyrtimit të 15 kërkesave të punëtorëve/palëve me dokumentacionin e bashkangjitur dhe vlerësimit të provave të paraqitura në emër të Grupit të Punëtorëve të kësaj NSh-j.

Komisioni ka konstatuar se objekti i shqyrtimit të kërkesave të lartcekura nuk hynë në kategorinë e kërkesave për privatizimin e banësive, sepse në faktë për nga struktura dhe destinimi dhe shfrytëzimi aktual janë lokale dhe jo banesa, dhe nuk i plotësojnë kushtet për shqyrtim bazuar në Ligjin për Shitjen e Banësive për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banësive"). Andaj për kërkesat e lartcekura Komisioni për Banesa ka rekomanduar të shpallet jo kompetent.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit




Nr. Ref. BD-225/6

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Menaxhmentit të AKP-së që qiramarrësi Mac Solution të mos ngarkohet më qiratë mujore për muajt shkurt dhe mars 2023 për arsye se është faturuar pa u nënshkruar kontrata e qirasë. Pra, vlera e qirave për këta 2 (dy) muaj të zbritet nga totali i borxhit për pagesë.

II. Refuzohet kërkesa e qiramarrësit për t'ia zbritur qiratë apo borxhin për periudhën maj, qershor, korrik, gusht, shtator dhe tetor 2024, dhe obligohet qiramarrësi që qiratë e papaguara për këtë periudhë t'i paguaj si pjesë e borxhit total të akumuluar dhe atë me këste për 12 muaj për asetin e NSh Metaliku.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e zbritjes së çmimit të qiradhënies sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Bazuar në deklaratim të parashtruesit të kërkesës se problemet derivojnë lidhur me supozimin që mbetet të cilat vijnë nga procesi i prodhim/përpunimit të mineralit të kromit mund të jenë helmuese të kontaminonjë tokën ekskluzivisht ndërlidhet me subjektin apo qiramarrësin Alfa Minerals e jo me Mac Solution dhe pse këto mbetje siç po duket janë menaxhuar apo derdhur në tokën të cilën e shfrytëzon Mac Solution, po ashtu nëse punët rreth përpunimit të mineralit të kromit janë ndaluar, ekskluzivisht ka të bëjë me lejen mjedisore të cilën qiramarrësi është dashur ta siguroj vetë.

Megjithatë, sa i përket faturimit për muajt shkurt dhe mars, AKP respektivisht DKAD nuk ka mundur të dëshmoj nëse qiramarrësi e ka shfrytëzuar asetin për këta dy muaj andaj, pretendimi i qiramarrësit në këtë aspekt ka arsye. DKAD dhe Menaxhmenti rekomandojnë që qiramarrësi Mac Solution të lirohet nga qiraja për muajt shkurt dhe mars 2023 sa i përket asetit- Tokës apo parcelës 116-2 për të cilën qiraja mujore është në vlerë prej 5,296.60 €/muaj apo në total 10,593.20 € për 2 (dy) muaj. Pra, edhe pse pala është kushtëzuar që nënshkrimi i kontratës së qirasë nuk mund të bëhet pa u shlyer disa obligime që ndërlidhen me subjektin Alfa Minerals (pronar apo aksionarë të njëjtë), ne nuk mund të konstatojmë se Mac Solution ka shfrytëzuar pronën për këto 2 muaj dhe rrjedhimisht pretendimet e tij që të lirohet për këta 2 muaj kanë bazë meqë është faturuar pa u nënshkruar kontrata e qirasë.

Ndërsa lidhur me kërkesën për lirim nga qiraja mujore apo zbritje të vlerës së qirasë mujore nga borxhi total për periudhën apo për muajt maj, qershor, korrik, gusht, shtator dhe tetor 2024, nuk ka bazë që nga borxhi total i qirave të papaguara të zbritet vlera e qirave për këto muaj sepse pengimi i punimeve ka ndodhur për shkak të mungesës së lejes mjedisore të cilën qiramarrësi është dashur ta siguroj vetë. AKP ka vepruar me vend kur është interesuar të sigurohet nëse këto mbetje nga përpunimi i mineralit të kromit janë të dëmshme për mjedisin.



Marrë parasysh nivelin e borxhit të akumuluar i cili deri më datë 28 shkurt 2025 është në vlerë prej 92,776.83 euro, në mënyrë që t'i mundësohet qiramarrësit pagesa e këtij borxhi, nga aspekti operacional dhe i likuiditetit, nevojitet që pagesa e borxhit të akumuluar bashkë me qiratë vijuese të bëhet me këste për 12 muaj.

Duke u nisur nga kronologjia e problemit, Bordi beson që vendimi është i arsyeshëm dhe do të përmbyllte përfundimisht këtë histori të gjatë duke marrë në konsideratë disa nga kërkesat apo pretendimet e qiramarrësit dhe në këtë mënyrë do të mundësonim fillimin e arkëtimit apo realizimit të borxhit, një vlerë të konsiderueshme të të hyrave në llogarinë e ndërmarrjes. Bordi po ashtu ka pas parasysh deklaratën e Menaxhmentit të ndërmarrjes të datës 29.04.2025 ku kanë konfirmuar që qiramarrësi nuk e ka pasur në posedim apo shfrytëzim pronën gjatë muajve shkurt-mars 2023 për arsye se kontrata nuk ka qenë e nënshkruar dhe si rrjedhojë qiramarrësi nuk ka ushtruar aktivitetet në pronë gjatë kësaj kohe.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/7

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve dhe Nenit 3.10.1 të Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa e palës Defrim Zejnullahu për lirim nga borxhi i papaguar në lidhje me qiramarrjen e asetit të NSH "Barnatoret e Prishtinës" PRN068, ashtu që i falet borxhi deri në shumën prej 2,208.14 Euro për periudhën e punimeve deri në dhjetor 2024.
- II. I lejohet Autoritetit të Likuidimit që të ri-programojë borxhin e papaguar të qirasë në shumën prej 3,481.30 Euro (borxhin deri në prill 2025) për periudhën e ardhshme një vjeçare për shkak të vështirësive financiare që ka pasur në operimin e këtij biznesi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës së palës për ndryshim të vendimit të Bordit sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Kontrata e parë është lidhur me palën Defrim Zejnullahu është lidhur më datë 30.11.2015 me nr. protokollit 8703/2015, ndërsa aneksi kontrata e fundit është lidhur më datë 04.04.2023 me nr. protokollit 46188/2023 dhe ka qenë efektive deri më datë 29.02.2024. Vazhdim të ri të kontratës së qirasë pala ka refuzuar të nënshkruajë për arsye se ka pretenduar në falje të borxhit për shkak të punimeve që janë zhvilluar. Në kërkesën e datës 01.02.2024 kërkonte që të lirohej nga pagesa e qirasë sipas tij për tërë periudhën sa do të vazhdohet këto punime, që nga shtatori 2023 deri në vitin 2026. Në kërkesën e datës 17.03.2025 kërkon që të lirohet për të paktën një vit, sepse tani hapësira ka nisur të lirohet paksa dhe tanimë është në gjendje të paguajë qiranë. Në e-mailin e datës 14 mars 2025 përmes e-mailit pala Defrim Zejnullahu drejtuar zyrtarit të rastit kërkon që të i ofrohet mundësia e pagesës me këste të borxhit të papaguar që sipas tij është faturuar pa e shfrytëzuar lokalin.

Pas kësaj kërkesë të datës 14 mars dhe kërkesave të mëhershme për lirim borxhi, që në vetvete përmbanin kërkesa me përmbajtje të ndryshme dhe për këtë situatë të pakuptimtë, Autoriteti i Likuidimit deklarantën e datës 14 mars 2025 e ka nënkuptuar si pohim të borxhit dhe i kishte kthyer përgjigje palës përmes zyrtarit të rastit më datë 18 mars 2025, ku i kishte sqaruar se për shkak të situatës pagesa me këste mund të i aprovohet. Pas kësaj më datë 07 prill 2025, pala Defrim Zejnullahu ka dërguar e-mail ku pretendon që është keq interpretuar e-maili i datës 14 mars dhe kërkon që kjo çështje të trajtohet nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

Kjo kontratë e qirasë, është kontratë e trashëguar nga ish-menaxhmenti dhe e cila është vazhduar pa ndërprerë deri më datë 29.02.2024 dhe vlera e kontratës së qirasë është në shumën prej 347.01 Euro për muaj. Borxhi total i papaguar deri në prill 2025 është në shumën prej 5,698.45 Euro.

Sipas vlerësimit të AL-së, kërkesa për lirim nga borxhi duhet të aprovohet pjesërisht dhe të paktën 50% e shumës së papaguar deri në dhjetor 2024 duhet të i zbritet nga borxhi total, sepse operimi me rregull i biznesit ka qenë i pamundur për arsye se edhe hyrja ka qenë e bllokuar.

M.H.



Pjesa tjetër 50% do të duhet të kërkohej të paguhet nga ana e qiramarrësit për arsye se nuk ka sjellë ndonjë dëshmi tjetër relevante për të dëshmuar që edhe përkundër vështirësive të operimit si biznes ka qenë i mbyllur gjatë tërë kohës.

Vlera e borxhit total deri në dhjetor 2024 është 4,416.29 Euro, dhe kështu lirimi nga pagesa prej 50% do të nënkuptonte që të lirohej për shumën prej 2,208.14 Euro, ndërsa pjesën tjetër prej 2,208.14 Euro do të jetë i obliguar ta paguajë. Borxhi prej 1,273.16 Euro paraqet periudhën prej Janar – Prill 2025 dhe kjo periudhë nuk do të përshihet në pjesën e falur të borxhit.

Për më tepër, AL konsideron që palës duhet të i mundësohet pagesa me këste e pjesës së borxhit të papaguar nga e cila nuk do të lirohet për periudhën e vlefshmërisë së kontratës së qirasë, do të thotë ristrukturim i borxhit për periudhën një vjeçare.

Borxhi i papaguar nga muaji janar 2025 e deri në prill 2025 nuk do të i llogaritet në faljen e borxhit për arsye se këtë borxh e ka pranuar dhe ka deklaruar se që nga kjo periudhë i njëjti ka filluar të operojë më në rregull.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-225/8

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 2.6 i Kontratës së Qirasë me nr. protokolli 3256/2016 në mes të NSH "NT Agimi" dhe NSH "Stacioni Bujqësor Gjakovë" dhe qiramarrësit Ardit Vokshi dhe Neni 127 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e palës Ardit Vokshi dhe i lejohet bashkëpunimi me kompaninë IP KOS Sh.P.K. dhe i jepet pëlqimi Autoritetit të Likuidimit që të nënshkruajë kontratën e qirasë me dy subjektet e lartëcekura për shumën prej 649.00 Euro/muaj për pronat e NSH "NT Agimi" dhe NSH "Stacioni Bujqësor Gjakovë".
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Pala Ardit Vokshi ka paraqitur kërkesë me nr. protokolli 1820 me datë 10.04.2025 nga ana e Ardit Vokshi, i cili është qiramarrës i asetit të NSH "NT Agimi" dhe NSH "Stacioni Bujqësor Gjakovë", për lejin e krijimit të bashkëpunimit me kompani tjetër dhe që të bëhet cedim i pjesshëm i kontratës së qirasë dhe rrjedhimisht në kontratë të qirasë të figurojnë dy qiramarrës, në këtë rast sipas kërkesës Ardit Vokshi dhe IP KOS Sh.P.K.

Ardit Vokshi ka kontratë të qirasë që nga data 12.12.2016 dhe këto kontrata kanë qenë të trashëguara dhe që është hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë në bazë të shfrytëzimit të aseteve.

Pala kërkon që si pasojë e rrethanave të krijuara dhe vështirësive ekonomike që ka hasur të i mundësohet dhe lejohet që të operojë në aset in e marrë me qira në bashkëpunim edhe me operatorin tjetër, IP KOS Sh.P.K. dhe që kontratën e qirasë ta nënshkruajnë si dy qiramarrës dhe zotohet që obligimet që dalin nga kontrata do të i përmbushin si dy palë. Aneksi i fundit i kontratës së qirasë është nënshkruar në dhjetor 2024 dhe është e vlefshme për periudhën nga 15.12.2024 deri më 14.12.2025 dhe pala qiramarrëse nuk ka ndonjë borxh të papaguar.

Ky aset është dhënë me qira përmes tenderit publik dhe është bërë rivlerësimi i qirasë, ku është rritur vlera e qirasë nga 600 Euro për muaj në 649 Euro për muaj. Ngastra ku ndodhet pompa ka ndërtime ilegale (objekte të ndërtuara para luftës) dhe është e kategorizuar për DSHD.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i pjesshëm i Kontratës së Qirasë dhe dhënia e pëlqimit që kontrata e qirasë të nënshkruhet me dy subjekte, përfshirë edhe qiramarrësin aktual, do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësit aktual nuk kanë ndonjë borxh të papaguar. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes ka vazhduar pa ndërprerje deri më sot, si dhe qiramarrësi aktualisht nuk ka ndonjë borxh. Bordi konsideron që dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës së qirasë nuk paraqet asnjë pengesë dhe nuk do të ishte rasti i parë përmes të cilit një kontratë qiraje lidhet me dy apo më shumë subjekte.

MH



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/9

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkruara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSh "Tregu" dhe parashtruesve të këtyre kërkesave, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë tek NSh Tregu:
 1. Nga El Tex Group SH.P.K. si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 37, me sipërfaqe prej 20 m², në emër të Jona Fashion SH.P.K., me numër unik identifikues 810857972, përfaqësuar nga Fatmir Azemi, në shumën prej 60.00 Euro/muaj;
 2. Nga Labinot Beka si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 52, 53, 86, 87, me sipërfaqe të përgjithshme prej 139.4 m², në emër të Labi Textil 25 SH.P.K., me numër unik identifikues 812266907, në shumën prej 150.00 Euro/muaj;
 3. Nga Naser Bullaku si qiramarrës i lokalit afarist nr. 13 në Tregun e Gjelbër (tek RTK), me sipërfaqe prej 2 m², në emër të Tuan Bullaku, me numër personal 1248054729, në shumën prej 80.00 Euro/muaj;
- II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të transferuara tek personat e lartcekur dhe ndërrimit të emrit, Qiramarrësit aktual do të jenë të obliguar të paguajnë borxhin e papaguar, ose në kundërtën do të ndermirren të gjitha veprimet ligjore për inkasimin e borxhit të papaguar dhe lirimin e hapësirave:
 - a) El Tex Group SH.P.K. si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 37, para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek Jona Fashion SH.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 221.68 €;
 - b) Labinot Beka si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 52, 53, 86, 87, para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek Labi Textil 25 SH.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 138.56 €;
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjelbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë



Ndërmarrja Shoqërore "Tregu" Prishtinë (PRN104) është në proces të likuidimit që nga data 14 korrik 2014. Gjatë këtij procesi, ndërmarrja ka vazhduar aktivitetet e saj, kryesisht përmes dhënies me qira të hapësirave afariste.

Më datë 04.07.2024, Zyra Rajonale Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokoli 25052/2024, të parashtruar nga subjekti El Tex Group SH.P.K., shfrytëzues i tokës afariste nr. 37, për transferimin e kontratës së qirasë nga El Tex Group SH.P.K. në emër të Jona Fashion SH.P.K.

Qiramarrësi El Tex Group SH.P.K. ka lidhur kontratën e qirasë me nr. protokoli 47425/2023, të datës 23.06.2023, për shfrytëzimin e tokës afariste të identifikuar me nr. 37, me sipërfaqe 20 m², e cila gjendet në Tregun me Shumicë (Tekstil), në Zonën Industriale të Prishtinës (ish-Fabrika e Amortizatorëve), me qira mujore prej 60.00 €. Kontrata është aktive dhe shuma e borxhit të papaguar është 221.68 €.

Më datë 23.04.2025, Zyra Rajonale Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokoli 26418/2025, të parashtruar nga Labinot Beka, shfrytëzues i tokës afariste nr. 52, 53, 86 dhe 87, për ndryshimin e emrit të subjektit në kontratën e qirasë nga Labinot Beka në Labi Textil 25 SH.P.K.

Qiramarrësi Labinot Beka ka lidhur kontratën e qirasë me nr. protokoli 47487/2023, të datës 23.06.2023, për shfrytëzimin e tokës afariste të përbërë nga njësitë nr. 52, 53, 86 dhe 87, me sipërfaqe të përgjithshme 139.4 m², e vendosur në Tregun me Shumicë (Tekstil), në Zonën Industriale të Prishtinës (ish-Fabrika e Amortizatorëve), me qira mujore prej 150.00 €. Kontrata është aktive dhe shuma e borxhit të papaguar është 138.56 €.

Më datë 18.04.2025, Zyra Rajonale Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokoli 26451/2025, të parashtruar nga Naser Bullaku, shfrytëzues i lokalit me numër identifikues 13, për transferimin e kontratës së qirasë nga Naser Bullaku (nr. personal 1002310798) në emër të Tuan Bullaku (nr. personal 1248054729).

Qiramarrësi Naser Bullaku ka lidhur kontratën e qirasë me nr. protokoli 43660/2022, të datës 03.10.2022, për shfrytëzimin e lokalit afarist të identifikuar me nr. 13, me sipërfaqe 2 m², i vendosur në Tregun e Gjellbër, Rr. "Ilaz Agushi", me qira mujore prej 80.00 €. Kontrata është aktive dhe nuk rezulton asnjë borxh i papaguar.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratave të Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Duke qenë se NSh Tregu është me karakter specifik dhe hapësirat e vendosura në tokën afariste janë të ndërtuara nga vetë qiramarrësit dhe të lejohet transferimi i kontratave të qirasë edhe pse në mes të qiramarrësit dhe personit që pranon transferimin e kontratës së qirasë nuk ka lidhje familjare dhe të kihet parasysh se cedimi apo transferimi i këtyre kontratave të qirasë ju bëhet personave që ushtrojnë veprimtari të tregtisë.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/10

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për ndryshimin e kontratës së qirasë nr. 51962/2024 të datës 22.04.2024, lidhur me N.Sh. "Ratar" (PRN115), me qëllim përjashtimin nga kontrata të parcelave që më nuk janë në pronësi të ndërmarrjes, si në vijim:

1. Miratohet qiraja mujore e përditësuar në shumën 2,090.00 € (dy mijë e nëntëdhjetë euro)/viti, në përputhje me çmimin për m² të aplikuar në kontratën ekzistuese për ngastrat, P-73414042-01855-0, me sipërfaqe 3,660 m², P-73414042-01857-0, me sipërfaqe 7,060 m², P-73414042-01858-1, me sipërfaqe 1,811 m², P-73414042-01864-0, me sipërfaqe 3,540 m² me sipërfaqe totale prej 16,071 m².

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për ndryshimin e kontratës të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

NSh "Ratar" (PRN115) është në proces të likuidimit që nga data 11.08.2014.

Kontrata e qirasë nr. 51962/2024, e lidhur më 22.04.2024, përfshinte një sipërfaqe të përgjithshme prej 29,335 m². Në bazë të dokumentacionit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe kontratave të shitjes direkte të miratuara nga AKP, është konstatuar se parcelat me numër P-73414042-01840-0 (4291 m²) është bërë transformimi në pronësi private, ndërsa parcelat P-73414042-01846-0 (2246 m²), P-73414042-01848-0 (2,246 m²) dhe P-73414042-01852-0 (4,481 m²) janë shitur përmes procedurës së shitjes direkte.

Totali i sipërfaqes së larguar është 13,264 m².

Sipërfaqja totale në bazë të kontratës së kaluar të qirasë ka qenë 2ha 93ari e 35m², në shumën totale prej 3,756.00 Euro për një vit kalendarik.

Ndryshimi i kësaj kontrate është i domosdoshëm për shkak se parcelat e përmendura më lart nuk janë më pjesë e portofolit të ndërmarrjes në likuidim, si rezultat i shitjes direkte të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së apo transformimit në pronësi private përmes vendimit nga ana e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Përfshirja e mëtejshme e këtyre parcelave në kontratë do të përbënte shkelje të ligjit dhe të dispozitave kontraktuale, duke ekspozuar ndërmarrjen ndaj rrezikut të kontestimeve juridike.

Autoriteti i Likuidimit ka vlerësuar se ndryshimi i kontratës është një përditësim teknik që nuk kërkon themelimin e ndonjë komisioni, pasi dokumentacioni mbështetës është i plotë dhe verifikimi i pronësisë është i konfirmuar nga institucionet përkatëse. Zbritja e qirasë është llogaritur në mënyrë proporcionale mbi bazën e sipërfaqes së mbetur dhe çmimit ekzistues për m².

Për më tepër, për parcelën P-73414042-01840-0 e cila është transformuar në pronësi private, është ndërmarrë veprim ligjor përmes paraqitjes së padisë dhe kërkesës për masë të përkohshme sigurie në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me qëllim të mbrojtjes së interesit të ndërmarrjes në proces likuidimi.



Në bazë të informatave që posedon Autoriteti i Likuidimit dhe informatat nga Zyra Rajonale Prishtinë ende nuk kemi ndonjë vendim nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Po ashtu, me të pranuar aktvendimin për bartjen e pronësisë, Autoriteti i Likuidimit kishte parashtruar ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Kjo Agjenci ka nxjerrë Aktvendim të datës 11.04.2024 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e parashtruar nga Autoriteti i Likuidimit dhe ka konsideruar se bartja e pronësisë nga ZKK Gracanice është bërë konform legjislacionit në fuqi.

Autoriteti i Likuidimit pasi që ka pranuar Aktvendimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, më datë 22.04.2024 ka parashtruar padi në konflikt administrativ ndaj aktvendimit të nxjerrë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Ndryshimi dhe vazhdimi i qirasë, konform sipërfaqes që shfrytëzohet nga qiramarrësi do të mundësonte inkasimin e të hyrave të vazhdueshme nga qiraja dhe do të reflektonte gjendjen faktike dhe juridike aktuale.

Autoriteti i Likuidimit i rekomandon Bordit të Drejtorëve të miratojë ndryshimin e kontratës së qirasë nr. 51962/2024, me qëllim që kjo kontratë të përditësohet në përputhje me gjendjen aktuale juridike të parcelave përkatëse. Pas këtyre përjashtimeve, në kontratë do të mbetet vetëm sipërfaqja reale prej 16,071 m², e cila është ende në pronësi të ndërmarrjes shoqërore "Ratar", për të cilën do të aplikohet qiraja mujore e përditësuar në shumën prej 2,090.00 €.

Parcelat që do të mbesin në kontratë janë si më poshtë:

P-73414042-01855-0 – 3,660 m²

P-73414042-01857-0 – 7,060 m²

P-73414042-01858-1 – 1,811 m²

P-73414042-01864-0 – 3,540 m²

Ky vendim do të sigurojë përputhshmëri të plotë të kontratës me gjendjen faktike dhe juridike të pronës, duke mundësuar vazhdimin e marrëdhënies së qirasë në mënyrë të ligjshme dhe transparente.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/11

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokoli 9155/2025 në mes të "NSHBQ Drenica", Drenas/Glllogoc dhe Hamit Bequku, dhe nenit 127 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferim të Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e tokës bujqësore në fshatin Çikatovë e re, Komuna e Drenasit/Glllogocit me sipërfaqe prej 3 hektarë, me qira vjetore prej 270.00 €.
- II. Obligohet pala që para nënshkrimit të kontratës së qirasë sipas kërkesës për transfer të paguajë pjesën e borxhit në shumën prej 270.00€.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratës të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim.

NSh "NSHBQ Drenica", Drenas/Glllogoc është në likuidim që nga data 09.06.2014.

Hamit Bequku është qiramarrës i tokës bujqësore në Fshatin Çikatovë e re, Komuna e Drenasit/Glllogocit me sipërfaqe prej 3 hektarë që nga dt. 12.04.2012 e tutje.

Më 19.05.2025 ZR Mitrovicë ka pranuar shkresën me nr. Prot: 5581/2025, nga personi fizik Hamit Bequku i cili kërkon që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga ai tek Daut Elshani, kjo për arsye se qiramarrësi Hamit Bequku ka obligime personale familjare. Gjithashtu, Hamit Bequku, ka bërë kullotjen e bagëtisë bashkërisht me Daut Elshanin.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi aktual nuk kanë ndonjë borxh të papaguar për vitin e kaluar dhe se do të bëjë pagesën për këtë vit sa më shpejt që është e mundur. Kjo kontratë është rivlerësuar nga Bordi. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes është vazhduar pa ndërprerje deri me sot, si dhe qiramarrësi ka qenë i rregullt me pagesa. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes ka vazhduar pa ndërprerje deri më sot, si dhe qiramarrësi aktualisht ka borxh në shumën prej 270.00 Euro të cilat do të jetë i obliguar të i paguajë para nënshkrimit të kontratës sipas vendimit mbi transferim të kontratës së qirasë.

Ky aset është në listën e aseteve të propozuara për fondin sovran dhe nuk është ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik. Aseti është në komasacion. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-225/12

Në bazë të neneve 2.1, 6.2, 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me objektin e vjetër dhe të dëmtuar që ndodhet në parcelën 00124-0 ZK Magure, Komuna Lipjan, pronë e NSh MIM Goleshi. Kërkohej dhe në të njëjtën kohë i lejohet KK Lipjan që të bëjë rrënimin e këtyre objekteve dhe pas rrënit të bëjë pastrimin e gjithë hapësirës.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit lidhur me kërkesën nga KK Lipjan në lidhje me rrënimin e objektit ekzistues në ngastrën 00124-0 ZK Magure sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim.

Objekti, rrënimi i të cilit është kërkuar në bazë të certifikatës pronësore ka një sipërfaqe prej 144 m². Sipas Inspektoratit, gjendja e rënduar dhe e rrezikshme e objektit është konstatuar edhe me procesverbalin nr. 00617 të datës 06.03.2025.

Agjencia ka marr informatën që objekti rrezikon të dëmtohet përmes kërkesës së paraqitur nga qytetari Liridon Trshana, i cili ka kërkuar që objekti të rrënohet pasi që po konsiderohet me rrezik të lartë për rrënim të papritur dhe kështu rrezikon sigurinë e atyre banorëve. Si rrjedhojë më datë, 26.02.2025 Agjencia i është drejtuar me kërkesë KK Lipjan ku është kërkuar që të bëjnë inspektimin dhe vlerësimin e sigurisë së objektit të dëmtuar në ngastrën 00124-0 ZK Magure.

Më datë 17.03.2025 kemi pranuar përgjigjen nga ana e Inspektoratit të Ndërtimit të KK Lipjan ku konstaton se rreziku i rrënit të tërësishëm të objektit qëndron dhe si rrjedhojë paraqet rrezik për banorët e kësaj zone. Sipas Inspektoratit, gjendja e rënduar dhe e rrezikshme e objektit është konstatuar edhe me procesverbalin nr. 00617 të datës 06.03.2025.

Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit më datë 18.03.2025 i është drejtuar KK Lipjan ku kemi kërkuar që të përmbahen nga çfarëdo veprimi deri në një vendim të Bordit të Drejtorëve dhe janë pyetur se a e marrin përsipër rrënimin dhe pastrimin e asaj pjesë, sipas autorizimeve që kanë organet komunale. Agjencia nuk ka pranuar asnjëherë përgjigje asnjëherë në shkresën e lartë cekur.

Duke u bazuar në gjendjen faktike në terren, e cila mund të vërehet edhe nga fotot mund të vërehet që gjendja e objektit është jo e mirë dhe me probabilitet të lartë të rrezikut nga shembja. Me lejmimin e rrënit do të evitohet shkaktimi i ndonjë rreziku, i cili do mund të kishte pasoja fatale dhe për më tepër do të eliminohej edhe përgjegjësia e AL/AKP-së në rast se paraqitet ndonjë rrezik i paralajmëruar sipas të vlerësimit të rrezikshmërisë nga ana e Inspektoratit të KK Lipjan.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/13

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.5 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të:

- a) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 574, 575 dhe 576 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 83.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Esat Krasniqi.
- b) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 153, 154, 201, 170, 370 dhe 558 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 166.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Fitim Kosumi
- c) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 629 dhe 640 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 55.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Veli Home SH.P.K – Enver Bislimi.
- d) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstruksion metalik nr. 622 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 28.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Albert Potera.
- e) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 397, 337 dhe 429 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 83.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Besim Kastrati.
- f) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstruksion metalik nr. 143 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 28.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Shaip Veliu.
- g) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 656, 654 dhe 653 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 83.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Begatin Gashi.
- h) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstruksion metalik nr. 111 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 79.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Nexhmi Kastrati.
- i) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 440 dhe 441 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 55.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Avni Makovci.
- j) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstruksion metalik nr. 22/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 139.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Bajram Hyseni.
- k) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 591, 592, 593, 594 dhe 595 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 139.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Ernes Rama.
- l) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 199, 216 dhe 247 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 83.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Agim Selmani.



- m) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 588 dhe 597 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 55.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Albion Binaku.
- n) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 442, 443, 480, 481 dhe 670 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 139.00 €/muaj për parashtruesin e kërkesës Zijad Avdiu.
- II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive parashtruesit e kërkesave para nënshkrimit të kontratave të qirasë do të duhet të paguajnë shumat si në vijim:
- a) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 574, 575 dhe 576 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Esat Krasniqi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muajt e kaluar (Prill-Maj 2025) shumën prej 166.00€ – respektivisht (83.00€/muaj × 2 muaj).
- b) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 153, 154, 201, 170, 370 dhe 558 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Fitim Kosumi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muaj (Maj 2025) shumën prej 166.00€ – respektivisht (166.00€/muaj × 1 muaj).
- c) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 629 dhe 640 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Veli Home SH.P.K – Enver Bislimi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muaj (Maj 2025) shumën prej 55.00€ – respektivisht (55.00€/muaj × 1 muaj).
- d) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstruksion metalik nr. 622 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Albert Potera duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muaj (Maj 2025) shumën prej 28.00€ – respektivisht (28.00€/muaj × 1 muaj).
- e) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 397, 337 dhe 429 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Besim Kastrati duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muaj (Maj 2025) shumën prej 83.00€ – respektivisht (83.00€/muaj × 1 muaj).
- f) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstruksion metalik nr. 143 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Shaip Velu duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muaj (Maj 2025) shumën prej 28.00€ – respektivisht (28.00€/muaj × 1 muaj).
- g) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 656, 654 dhe 653 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Begatin Gashi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muaj (Maj 2025) shumën prej 83.00€ – respektivisht (83.00€/muaj × 1 muaj).
- h) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstruksion metalik nr. 111 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Nexhmi Kastrati duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muaj (Maj 2025) shumën prej 79.00€ – respektivisht (79.00€/muaj × 1 muaj).
- i) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 440 dhe 441 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Avni Makovci duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muaj (Maj 2025) shumën prej 55.00€ – respektivisht (55.00€/muaj × 1 muaj).
- j) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me konstruksion metalik nr. 22/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Bajram Hyseni duhet të paguajë



- retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muaj (Prill-Maj 2025) shumë prej 278.00€ – respektivisht (139.00€/muaj × 2 muaj).
- k) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 591, 592, 593, 594 dhe 595 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Ernes Rama duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muaj (Prill-Maj 2025) shumë prej 278.00€ – respektivisht (139.00€/muaj × 2 muaj).
- l) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 199, 216 dhe 247 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Agim Selmani duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muaj (Prill-Maj 2025) shumë prej 166.00€ – respektivisht (83.00€/muaj × 2 muaj).
- m) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 588 dhe 597 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Albion Binaku duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muaj (Maj 2025) shumë prej 55.00€ – respektivisht (55.00€/muaj × 1 muaj).
- n) Tokë afariste në të cilën janë të vendosura depot me konstruksion metalik nr. 442, 443, 480, 481 dhe 670 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Zijad Avdiu duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muaj (Maj 2025) shumë prej 139.00€ – respektivisht (139.00€/muaj × 1 muaj).

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim.

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesit e këtyre kërkesave, tanimë edhe shfrytëzuesit e këtyre hapësirave do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Prona e cila do të vlerësohet për dhënie me qira, sipas dokumentacionit të poseduar nga AKP, ZR Prishtinë, dhe sipas listës së aseteve, është tokë afariste përkatësisht treg.

Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar 14 kërkesa zyrtare nga aplikues të ndryshëm, të cilët kanë kërkuar qiradhëniën direkte të hapësirave afariste (toka) për qëllime magazinimi (depo) në këtë zonë. Të gjitha kërkesat janë protokolluar dhe përfshijnë hapësira që aktualisht shfrytëzohen pa kontratë të rregullt me AKP-në, në pritje të formalizmit përmes kontratave të rregullta të qirasë.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 376/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë për asetet të cilat nuk kanë mundur ti sigurojnë herën e parë e vendim të DE 349/2024, prandaj bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren janë matur asetet e mëposhtme dhe çmimi i hapësirave të ofruar me qira tek Tregu me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë duhet të jetë sipas matjeve të paraqitura në raportin e vlerësimit.



Kësisoj, Autoriteti i Likuidimit konsideron që është e arsyeshme dhe legjitime që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga data kur secili ka hyrë në shfrytëzim të këtyre hapësirave. Andaj, nga palët do të kërkohet që para nënshkrimit të kontratës të paguajnë shumën e qirasë në mënyrë retroaktive nga datat e poshtëshënuara për secilin prej tyre.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/14

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.1 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit dhe refuzohet kërkesa për qiramarrje direkte nga Emira Begisholli për hapësirën që ndodhet në katin i në sipërfaqe prej 8.84 m2 në ndërtesën administrative të NSh Bankkos, Ferizaj.
- II. Obligohet Menaxhmenti/AL që këtë hapësirë ta vendosë në tender publik të qiradhënies së aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore si njësi të veçantë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për refuzimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim

Më datë 12 maj 2025 është pranuar një kërkesë nga ana e Emira Begisholli e cila ka kërkuar këtë hapësirë me qira me qëllim që ta shfrytëzojë si zyrë për agjension të patundshmërive.

Në bazë të informatave nga Zyra Rajonale Prishtinë, konstatojnë faktin që ky aset ka dal disa herë si ofertë për qiramarrje përmes tenderit publik dhe asnjëherë nuk është pranuar ndonjë ofertë.

Në bazë të raportit të vlerësimit, Autoriteti i Likuidimit konsideron që kjo hapësirë nuk ka qenë asnjëherë asnjëherë e ofertuar me qira, për arsye se në tender publik kanë qenë të vendosur kati 2-të dhe 3-të, mirëpo asnjëherë kati i parë, siç mund të vërehet në bazë të dokumenteve bashkëngjitur.

Sipas vlerësimit të AL-së, në bazë të dëshmive bashkëngjitur mund të konstatohet se kjo hapësirë asnjëherë nuk është vendosur në tender publik të qiradhënies, saktësisht zyra në katin e I-rë, si njësi e veçantë.

Në raportin e vlerësimit, ceket se kemi të bëjmë me hapësirën në katin e I-rë, mirëpo në shpalljet përmes tenderit publik ceket që janë vendosur hapësirat e katit 2-të dhe 3-të, ku i tërë kati ka dal si njësi e vetme për tender publik. Për shkak të mungesës së resurseve humane Zyra Rajonale Prishtinë nuk ka mundur që të bëjë matjen e secilës zyre veç e veç në të kaluarën dhe të i vendos në tender si njësi të veçantë.

AL ka kërkuar sqarim nga ZR Prishtinë, ku janë informuar se emërtimi si kati i 2-të dhe 3-të në shpalljet publike është bërë gabimisht, sepse kemi të bëjmë realisht me katin e parë (menjëherë pas përdhësës).

Në këtë rast AL dhe Bordi vlerësojnë se kjo hapësira dhe hapësirat tjera brenda këtij objekti duhet të dalin në tender publik si njësi të veçanta dhe në këtë formë besojmë se do të pranoheshin oferta, sepse kjo mund të justifikohet me faktin që në rast se do të vendosen si njësi të veçanta atëherë edhe mund të priten oferta më të shumta.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordit Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/15

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.4 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 1171 m² të parcelës 01096-0 zona kadastrale Gjakovë në pronësi të NSh "Emin Duraku" PEJ110, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 450.00 për një muaj kalendarik për palën Jakova Construction me përfaqësues Valon Vula.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim.

Me datën 30.04.2025 Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar kërkesën nga parashtruesi Jakova Construction me përfaqësues Valon Vula që të i'a mundësojë qiramarrjen e asetit përkatës. Vendndodhja e pronës është në qendër të qytetit të Gjakovës, në Rr. "Fan Stilian Noli" si oborr i qendrës së banimit dhe parcela është në gjendje të rregullt dhe ka qasje në infrastrukturë.

Objekti i vlerësimit sipas dokumenteve të pronës, është toka e cila gjendet në qendër të qytetit të Gjakovës dhe është si oborr i qendrës së banimit (banesë kolektive). Toka ka një infrastrukturë të rregulluar mirë dhe gjendet në një lokacion të përshtatshëm për aktivitete komerciale. Bazuar në dokumentet kadastrale të Kosovës, prona është e regjistruar në emër të ndërmarrjes. Sipas gjendjes së dhënë në dokumente pronësore, prona ka sipërfaqe prej 1171 m², mirëpo hapësira që mund të shfrytëzohet për vend parkim është sipërfaqja prej 853 m² dhe sipas kërkesës së palës pjesa më e madhe shfrytëzohet nga ana e banorëve dhe dyqaneve përreth si vend parkim, ndërsa pjesën prej 400 m² pala kërkon që ta shfrytëzojë si vend parkim me pagesë, të cilin veçse e shfrytëzon aktualisht si të tillë.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 965/2025 të u.d. Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për parcelën nr. 01096-0 me sipërfaqe prej 1171 m², e cila gjendet në Gjakovë është në shumën prej 450.00 Euro/muaj.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

MH



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/16

Në bazë të nenit 15.1 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 3 të Rregullores Nr. 03/2025 për qiradhënien e aseteve të NSH-ve, Nenit 3.10.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Kontratën qirasë me nr. protokollit 52113/2024 të datës 07.05.2025 dhe me nr. protokollit 52381/2024 e datës 20.06.2024, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa për fshirjen e borxhit dhe për ndryshim të kontratës së qirasë sa i përket destinimit si kontratë për tokë bujqësore për asetën e NSH Auto Moto e Kosovës për qiramarrësin Business and Strategy Consulting Sh.P.K. përkatësisht shumë prej 143,260.93 Euro dhe për fshirjen e borxhit të faturuar për qiramarrësin New Group Real Estate Sh.P.K. për shumë prej 90,029.27 Euro.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi çështjen lidhur me asetën e NSH Auto Moto e Kosova dhe vendosi sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim:

Aseti 07587-2 ZK Prishtinë me sipërfaqe prej 12584 m2 është lëshuar me qira përmes tenderimit publik dhe ka qenë i paraparë destinimi komercial. Oferta më e lartë ka qenë në shumë prej 14,888.00 Euro dhe më pastaj ofertuesi i parë i suksesshëm ishte tërhequr nga oferta dhe është ftuar pala e dytë me çmimin më të lartë dhe është lidhur kontrata për destinim komercial me palën Business and Strategy Consulting Sh.P.K.

Po ashtu, edhe kontrata e qirasë për asetën 07585-2 ZK Prishtinë me sipërfaqe prej 4573 m2 është lidhur përmes procedurave të tenderimit publik dhe oferta më e lartë ka qenë në shumë prej 8,000.00 Euro dhe si rrjedhojë është lidhur kontrata e qirasë me palën New Group Real Estate Sh.P.K. për destinim komercial.

Më datë 28.10.2024 është pranuar kërkesa nga ana e BSC-së, ku të njëjtit pretendojnë që janë vendosur në lajthitje duke e marrë parcelën në fjalë me qira për zhvillim të aktiviteteve komerciale dhe rrjedhimisht konsiderojnë që janë dëmtuar.

Të njëjtat pretendime janë paraqitur edhe në kërkesën e New Group Real Estate të datës 15.11.2024, ku shfaqin shqetësimet e tyre në lidhje me dëmtim që ju ka ndodhur si pasojë e mos dhënies së lejes për të punuar dhe zhvilluar aktivitete komerciale në hapësirën e marrë me qira. Tek e njëjta më vonë vërehet që përfaqësuesi i kompanisë është ndërruar sipas procedurave të parapara nga ARBK dhe në marrëveshje në mes të palëve.

Agjencia gjegjësisht AL e NSH Lidhja Auto Moto e Kosovës ka lidhur kontratën e qirasë për destinim komercial dhe për ushtrimin e aktiviteteve të përshkruara si më lartë, qiramarrësit kanë deklaruar që kanë hasur në pengesa të cilat janë të natyrës juridike dhe nuk kanë mundur që të ushtrojnë veprimtaritë e caktuara si rrjedhojë se nuk janë lejuar nga Komuna e Prishtinës duke i njoftuar që është si zonë e paraparë për shërbime publike.

AKP- në shpalljen publike për qiradhënie të aseteve të dt. 13 shkurt 2024, ndër të tjera tek pjesa "Dispozitat e Përgjithshme" ka njoftuar gjithë ofertuesit me informatën si në vijim: "Asetet e tenderuara ofrohen për dhënie me qira "ashtu siç janë" dhe "ku janë". Ofertuesit kanë përgjegjësi të verifikojnë përshkrimin dhe kushtet e aseteve (gjendjen faktike) dhe AKP respektivisht Autoriteti i Likuidimit i NSH-ve përkatëse do të konsiderojë se ofertuesit

MH



kanë dijeni të mjaftueshme në lidhje me pronat e ofruara për qiradhënie dhe nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë pengim të posedimit-shfrytëzimit eventual". Pra AKP-ja nuk mund të jetë përgjegjëse për mos shfrytëzimin e aseteve pasi që blerësi ka qenë i njoftuar dhe është dashtë ti ndërmarr veprimet dhe të njoftohet për mundësitë e shfrytëzimit të asetit dhe se duke marr parasysh lokacionin e aseteve-parcelave shfrytëzimi i tyre nuk ka pas si të jetë ndryshe pos komerciale. Po ashtu AKP-ja nuk e ka kufizuar palën në shfrytëzimin e asetit për një kategori të caktuar të biznesit por janë cekur disa sosh në pjesën B të kontratës së qirasë.

Po ashtu bazuar në nenin 591 të LMD parashihet se "Qiradhënësi nuk përgjigjet për të metat e sendit të marrë me qira të cilat në momentin e lidhjes së kontratës kanë qenë të njohura për qiramarrësin, ose nuk kanë mundur t'i mbeten të panjohura".

Pala ka njoftuar që ka pengesa në shfrytëzim të pronës disa muaj pas lidhjes së kontratave pra më datë 28.10.2025. Ky fakt është në kundërshtim me nenin 8.1 të kontratës ku qiramarrësi do të duhej të njoftonte AKP-ën brenda 15 ditës.

Qiramarrësi asnjëherë nuk ka pas pengesa nga qiradhënësit në ushtrimin e veprimtarisë së tij dhe kjo është në përputhje me nenin 7 të kontratës dhe nuk ka obligim ta siguroj qiramarrësin nga palët tjera qofshin ato edhe institucione sikurse është Komuna sepse edhe shpallja publike e qiradhënies nuk ka përfshirë një ndonjë sigurim të tillë. Për më tepër shpallja publike është bërë me 13 shkurt 2024 dhe dita e dorëzimit të ofertave ka qenë me datë 28 shkurt 2024 dhe qiramarrësit kanë pasur kohë mjaftueshëm të interesohen për pronën për të cilën do të ofertojnë dhe planet eventuale të Komunës për atë pronë.

Bordi konsideron se qiramarrësit kanë dështuar në zbatim të kontratave sipas nenit 6.1 (c), 6.1 (h). Bordi konsideron se qiradhënësi nuk ka dështuar në obligimet e tij sipas nenit 6.2 të kontratave.

AKP gjegjësisht AL do të jetë e obliguar të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të arkëtuar borxhin që palët kanë sipas kontratave të qirasë.

Duke marr parasysh të gjitha faktet e sipërpërmendura, Bordi shqyrtoi propozimin lidhur me kërkesën e palës dhe konstatoi se nuk ka bazë ligjore për të fshirë borxhin dhe për ndryshim të kontratës së qirasë sa i përket destinimit si kontratë për tokë bujqësore dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-225/17

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores nr.03/2025 për qiradhënien e NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratës të qirasë për shfrytëzimin e objektit të Conitex me sipërfaqe të përgjithshme prej 19,341m², pronë e NSH Jatex nga subjekti "Ventius International" L.L.C tek subjekti "PROEX" sh.p.k.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për transferin e kontratës të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Kontrata që është objekt i transferimit përfshin periudhën 01.07.2024 – 30.06.2025 dhe lidhet me objektin e njohur si "Conitex" në Gjakovë, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Jatex" dhe aktualisht qiraja mujore është në vlerën prej 4,500.70 €.

Më datë 22 prill 2025, Divizioni për Kontroll dhe Administrim Direkt (DKAD) ka pranuar kërkesën zyrtare nga "Ventius International" për transferimin e kontratës së qirasë të subjekti "PROEX" sh.p.k.

Kjo kërkesë është rezultat i ndryshimeve të fundit organizative dhe strategjike në kuadër të një projekti të përbashkët midis dy operatorëve ekonomikë, ku "PROEX" sh.p.k do të marrë rolin kryesor në implementimin dhe menaxhimin e investimeve të planifikuara.

Bazuar në kapacitetet teknike, menaxheriale dhe financiare të subjektit "PROEX" sh.p.k, palët kanë vlerësuar se transferimi është në interes të përbashkët dhe parakusht për realizimin me sukses të projektit zhvillimor në objektin "Conitex". "Ventius International" L.L.C ka qenë një qiramarrës i rregullt dhe i përkushtuar në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale që nga hyrja në fuqi e kontratës më 01.07.2024. Aseti që është marrë me qira përfshin sipërfaqen prej gjithsej 19,341 m².

Më datë 15 tetor 2024, Bordi i Drejtorëve i AKP-së, me vendimin Nr. Ref. BD-211/85, ka miratuar bashkëpunimin e qiramarrësit me operatorë tjerë ekonomikë në funksion të zhvillimit të asetit,


Bazuar në këtë vendim dhe në përmbushjen e kushteve të parashtruara, DKAD vlerëson se transferimi i kontratës të "PROEX" sh.p.k: Siguron kontinuitetin e kontratës dhe të të hyrave për NSH "Jatex" pa ndërprerje, mundëson realizimin në kohë të projektit të investimeve që janë të një rëndësie strategjike për valorizimin e asetit, rrit potencialin për gjenerimin e të ardhurave të qëndrueshme dhe maksimizimin e vlerës së asetit për Ndërmarrjen Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit




Nr. Ref. BD-225/18

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10.1.4 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të parcelave që gjenden në zonën kadastrale Breg i Madh, Zubin Potok, në pronësi të NSH "LOLA Vegllaria" MIT028 me sipërfaqe prej 11254 m² për Electro Plus sh.p.k sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 2,000.00 Euro/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim.

Më datë 03.09.2024 dhe me datë 23.05.2025 janë pranuar dhe precizuar kërkesat nga Electro Plus sh.p.k për qiramarrjen e parcelave me numër P-72908020-02359-0 (pjesa), 02438-0 (pjesa), 02440-0 (pjesa), 02441-0, 02444-0 (pjesa), 02449-0 (pjesa), dhe 02450-0 (pjesa) të cilat gjenden në zonën kadastrale Breg i Madh, Zubin Potok me sipërfaqe të tërësishme prej 11254 m².

Lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 967/2025 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për me numër P-72908020-02359-0 (pjesa), 02438-0 (pjesa), 02440-0 (pjesa), 02441-0, 02444-0 (pjesa), 02449-0 (pjesa), dhe 02450-0 (pjesa) të cilat gjenden në zonën kadastrale Breg i Madh, Zubin Potok me sipërfaqe të tërësishme prej 11254 m² e cila gjendet në zonën kadastrale Breg i Madh, Zubin Potok është në shumën prej 2,000.00 Euro/muaj.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevojat të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'i ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padinë pranë Komisionit të Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025

Mentor Hyse
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit
X



Nr. Ref. BD-225/19

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.8 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 maj 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të pjesës së parcelës nr. 301 në Kamenovo, Mal të Zi në sipërfaqe prej 74.3 m2 për kompaninë "Blue Marlin" D.O.O. përfaqësuar nga Nikola Pejovic sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 1,900.00 Euro për një vit kalendarik për asetën e NSh Derma Commerce, MIT038.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim.

Kjo ndërmarrje ka vazhduar me aktivitetet e saj edhe gjatë procesit të likuidimit por kryesisht në qiradhënie të asetëve të mbetura. Kjo NSh është bashkëpronare në ngastrën kadastrale nr. 301 në Kamenovo të Malit të Zi, në pjesën ideale prej 1/86 apo së sipërfaqe prej 74.3 m2.

Më datë 10.04.2025 është pranuar kërkesa nga ana e Kompanisë "Blue Marlin" D.O.O. për dhënien e pëlqimit nga NSh Derma Commerce, në cilësinë e bashkëpronarit për ngastrën nr. 301 në mënyrë që përmes marrjes së pëlqimit të i mundësohet pjesëmarrja në tenderin publik të marrjes me qira të plazheve publike në Kamenovo. Sipas palës, këta kanë qenë qiramarrës të hapësirës në fjalë për shumë vite dhe të njëjtit e mirëmbajnë dhe po ashtu kanë siguruar edhe dy pëlqimet nga dy bashkëpronarët e tjerë. Autoriteti i Likuidimit përmes e-mailit ju është përgjigjur në kërkesën e tyre, duke ju sqaruar se aktualisht një pëlqim i tillë nuk mund të lëshohet por nëse pala është e interesuar mund të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë. Po ashtu, ju është kërkuar që të na i dërgojnë dëshmitë që kanë marrë pëlqimet nga bashkëpronarët tjerë, dhe po ashtu ju është kërkuar që nëse kanë të na dërgojnë një skicë të pjesës prej 74.3 m2. Të njëjtit më datë 23 maj 2025 kanë kthyer përgjigje, ku pajtohen që fillimisht të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë dhe pastaj të sigurojnë pëlqimin dhe deklarojnë që kjo hapësirë do të shfrytëzohet vetëm si hapësirë për plazh. Po ashtu, kanë deklaruar që nuk mund të sigurojnë një skicë të vetëm kësaj pjese, sepse bashkëpronësia nuk është e ndarë dhe kanë dërguar pëlqimin e bashkëpronarit.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 968/2025 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për hapësirën me sipërfaqe prej 74.3 m² i cili gjendet në Kamenovo, Mal të Zi është në shumën prej 1,900.00 Euro/për një vit kalendarik pasi që sipas përshkrimeve në raport të vlerësimit, sezona është e paraparë deri në gjashtë muaj.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevojat e NSH-së apo do të



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit